

VENDIM
Nr. 7, datë 29.1.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“HYDRO POWER PLANT OF KORCA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES PËR “HEC VERBA 1” DHE “HEC VERBA 2” SI BURIM I RINOVUESHËM
ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009 dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 29.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro power plant of Korca” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC Verba 1” dhe “HEC Verba 2”, si burim i rinoveshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hydro power plant of Korca” sh.p.k., është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC Verba 1” dhe “HEC Verba 2” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani